



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANE

K Ë R K E S Ë

“Për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit”

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
TIRANE

Në Tiranë, sot në datën 27.01.2019, ora 09:45

Unë Alma Bramo, prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi studiova aktet e arrestit të shtetasve:

1. Esat Cani, i biri Reshit dhe i Hajrije, dtl.30.05.1988, lindur dhe banues ne Bastar i Mesem Tiranë, me gjendje civile martuar, me gjendje gjyqësore i pa dënuar më parë, me kombësi e shtetësi Shqiptare, per kryerje te vepres penale te “Plagosjes se rende me dashje” me pasoj vdekje, parashikuar nga neni 88/2 K.Penal;

2. Defrim Kurti, i biri i Ismail dhe i Hamide, dtl.19.02.1990, i lindur dhe banues ne Zall Bastar, me gjendje civile martuar, me gjendje gjyqësore i pa dënuar më parë, me kombësi e shtetësi Shqiptare, per kryerje te vepres penale te “Veprime qe pengojne zbulimin e se vertetes”, “Prodhim dhe shitje te lendeve narkotike, parashikuar nga neni 301 e 283 te K.Penal;

3. Elida Cani, e bija e Reshid dhe e Hajrije, e datelindjes 27.03.1999, e lindur ne Tirane Bastar i Mesem, Tirane, shtepi private, me gjendje gjyqësore e padenuar me pare, e martuar, me arsim 9 klase, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, per kryerje te vepres penale te “Veprime qe pengojne zbulimin e se vertetes” parashikuar nga neni 301 K.Penal;

KONSTATOVA

Më datë 24.01.2019 rreth ores 21:00 ne vendin e quajtur Bastar i Mesem ka ndodhur nje ngjarje, dhe konkretisht; me date 25.01.2019 eshte marre informacion ne Sallen Operative se ne Spitalin e Traumes Tirane(Laprake) eshte praqitur nje shtetas me demtime ne koke demtime te renda, i cili ka vdekur (nuk dihet gjate rruges apo ne spital, por pritet akti ekspertimit mjeko ligjor te kufomes.

Nga veprimet e para hetimore ka rezultuar se viktima Arben Gjeci prej disa muajsh kishte lidhje jashtëmartesore me shtetasen Elida Cani, e martuar me të arrestuarin Dëfrim Cani.

Ajo dhe viktimja janë banorë të fshatit Bastar. Ditën e ngjarjes ata janë takuar pranë abinti të braktisur që ndodhet pranë banesës së saj dhe më pas ata janë futur në dhomën e arbenit të shtetases Elida Cani. Dhoma ka dalje në oborrin e shtëpisë dhe në momentin që viktimja do të dilte nga banesa e shtetases Elida Cani, kjo e fundit ka dalë e para dhe ka ruajtur ambinetin me fushëpamje që të mos vërente praqinën e ndonjë personi. Pasi ka kontrolluar ajo i ka thënë viktimës të dalë duke e ruajtur nga një distancë e afërt. Ai ka dalë nga oborri nëpjet një dere dhe Cani deklaron se e ka parë në momentin e fundit nga pas. Ajo ka dëgjuar zhurma goditjeje dhe ka kuptuar se Gjecin e kanë goditur. Ka shkuar pranë tij dhe e ka parë të gjakosur i ka thirrur disa herë por ai bënte zhurma pa arritur të komunikojë me të. Ajo ka marrë me telefonin e tij vëllanë e Viktimës Musa Gjeci dhe i ka shpjeguar se Arbenin e kanë goditur por nuk është e sigurtë nëse ky i fundit e ka dëgjuar çfarë i është thënë për shkak të erës që frynte. Më pas e shqetësuar ka njoftuar bashkëshortin e saj Dëfrim Cani që ndodhej në një lokal larg banesës duke i thënë fillimihst të vinte dhe pas isa telefonatane i ka thënë të vinte se një person ka vdekur pranë banesës së tyre.

Ajo i ka shpjeguar se Arben Gjeci kishte ardhur ta takonte dhe se dikush e ka vvarë. Dëfrim Cani i ka thënë se do të vinte të rregullonte gjithcka dhe e ka pyetur nëse prindërit e dinin këtë fakt. Ai i ka thënë të pastronte gjakun. Ai ka ardhur dhe e ka marrë shtetasin Arben Gjeci ndërsa shtetasja Elida Cani e ka pastruar vendin e ngjajres duke larë gjakun dhe sipër i ka hedhur një sasi tallashi. Ajo i ka bërë me dije bashkëshortit se nuk e dinte kush e ka qëlluar Gjecin.

Ajo ka sqaruar se ka ne perdorim numrin telefonik 0698294895, si dhe nje numer tjeter qe e kam thyer 0692343055, qe të mos merrej vesh lidhja e saj me shtetasin Arben Gjeci. Deklaron se ka folur me të edhe nga numri i vjehrrës me te fshehtas.

Ajo ka deklaruar gjithashtu se kur janë takuar viktimja Gjeci i ka shprehur shqetësimin duke i thënë se ka pasur përshtypjen se dikush e ka ndjekur ndërsa shkonte aty. Ajo ka deklaruar se në dijëninë e saj lidhjen e tyre nuk e dinte njeri. Shtetasi Defrim Kurti e ka transportuar viktimën larg shtëpisë dhe ka marrë në telefon shtetasin Ibrahim Cani duke i thënë se ka gjetur dikë të shtrirë në rrugë që lëshon zhurma dhe ka frikë ti afrohet. Shtetasi Ibrahim Kurti ka shkuar në vendngjarje dhe ka thirr vëllanë Beshir Cani të shkonte atje pasi ishte lajmëruar nga Dëfrimi se ka gjetur një person të plagosur dhe se ai ishte shtetasi Arben Gjeci i cili ishte fshatar i tyre dhe njëkohësisht shofer i linjës së furgonave të zonës. Pasi janë takuar të tre kanë shkuar matane përroit kanë parë të shtetases Arben Gjeci, i cili renkonte por nuk fliste, ishte i lagur pasi binte pak shi si dhe ishte i gjakosur ne koke ne anen e majte, po ashtu gjak kishte edhe ne xhup dhe ne triko. Ne te tre se bashku e kanë marre ne krahe dhe e kanë cuar të shtëpia e shtetasit Beshir Kurti ku i kanë hequr te gjitha rrobat ne brez e siper pasi dridhej, kishte ftohte dhe i kemi hedhur dy tre batanije qe te ngrohej si dhe i kam future me shume dru sobes qe te ngrohej me shume ambientit. Nderkohe ka marrë ne telefon vëllain e Arbenit, shtetasin Cac Gjeci te cilit i ka se e ka gjetur Benin jashte te vrare, dhe të gjente ndonje makine për ta cuar ne spital. Shtetasin Musa Gjeci ai deklaron se e kam marre dy tre hetre ne telefon pasi me dukej se po vonohej dhe nuk po vinte shpejt dhe pas rreth 10 minuta ose 15 minuta kane ardhur së bashku me shtetasin Fadil Kabili i cili drejtonte nje makine foristrade si dhe me ta ishte edhe nje komshi tjeter i Cacit shtetasi Ylber Doka. Ai ju ka thënë të merrte një ambulance qe te na dilte perpara qe ti shpetonin jeten.

Rrugës kanë takuar mabulancën dhe janë nisur drejt Tiranës për në spital.

...i pare qe e ka pare te shtrire dhe te demtuar ka qene shtetasi Defrim Kurti, i cili ka
ne telefon shtetasin Ibrahim Cani duke i thene "dil pak perpara se kam frike, se cfare
on perpara meje".

njëjtën rrjedhë ngjarje tregon edhe shtetasi Ibrahim Cani.

Nga verifikimi i thenieve te shtetasit Defrim Kurti, me procesverbalin e verifikim te thenieve,
vertetohet ku ai me gisht na ka treguar se ku e ka gjetur kufomen ne deren, me pas e ka marre
ate dhe e ka derguar ne lagjen "Bakutja" duke lene ne ane te rruges.Me pas ka shkuar ne
parcelen e shtetasit Sul Kurti, ku kishte hequr bluzen e tij me njolla gjaku, dhe e kishte
fshehur poshte nje rrase guri, si dhe ka fshehur, po ne kete parcele ne murin rrethues ne mesin
e saj kishte fshehur telefonin "Iphone" me ngjyre blu e te bardhe qe i perkiste shtetasit
viktimes Arben Gjeçi.Me pas ai ka levizur me mjet per ne drejtim te qytetit Tirane.

Nga kqyrja e vendit te ngjarjes dhe pikerisht ne oborrin e shtetasit Ismail Kurtit, ne
pjesen qe perkon me murin e baneses dy kateshe te pa banuar, me fasaden e murit te depos,
ku ndermet saj e ndane nje dere prej druri qe ndan nje oborr. Si pike referimi u more kendi i
murit te shenuar me PO.Nga kjo distance PO 1.7m dhe 70 cm nga baza e murit prej guri, te
magazines me Tab. Nr.1 evidentohen mbetje si te gjakut, ne nje shtrese copeza druri si
tallash.Ne distance 15 cm nga Tab nr.1, evidentohen mbetje po te njejta.Ngjitur me Tab nr.
1, jane dy elemente drusore te mbeshtetur ne toke dhe ne mure me gjatesi 88 x 90 cm ku ne
pjese te tyre ishin me njolla te kuqe si te gjakut.Te dy keto elemente drusore u paketuan ne
cilesin e proves me nr. Serial C 10019208.Nga ana jone po me tampon steril, u more njolla
per ekzaminim biologjik, si dhe mbetje te copave te tallashit.Kqyerja vazhdoi ne dhomen e
gjumit te shtetasit Defrim Kurtit, e cila eshte 4 m nga PO.Ne dhomen ne krahe te raftit u gjete
nje bluze me gri me roze me dekorim "Adidas", e cila evidentohet me Tab nr.3, e cila meret
ne cilesin e proves per ekzaminim biologjik.Ne sirtarin e krahut te majte kati pare, u gjete nje
qese plastike ku brenda saj kishte lene e dyshuar si cannabis sativa, e cila pas ambalaxhimit
dhe peshim rezultoj me peshe 6,2 gr, dhe futet ne qese prove A0001520.Kqyerja vazhdoi ne
rruges e fshatit duke ecur ne rruge me gure dhe distance 15 m, nga rrjedhja e prroit(drejtimi
nga rruga e fshatit per tek banesa e shtetasit Reshit Cami), dhe pikerisht ne vendin e quajtur
lagje "Bakutja", ne toke verehen mbetje me ngjyre te kuqe si te gjakut, dhe evidentohet me
Tab nr.6, qe rezulton mase glukoze dhe me tampon steril u more substance per ekzaminim.Po
ne kete vend me Tab nr.7 e 8 u moren mbetje te kuqe si te gjakut.

Kufoma iu nenshtrua kqyerjes ne morgun e IML-se Tirane, me plage ne koke me
qepje me permasa te ndryshme.Per te percaktuar nese viktima eshte kacafytur apo problem te
tjera nga ana jone ju morem mbetje thonjshe.Nga kqyerja e kufomes eshte marre mbetje
thonjshe per kezaminime te metejshme ne laborator kriminalistik, si ju eshte marre kampion
gjaku per analiza te AND-se.

I është marrë deklaron shtetasit Esat Cani, vëllai i shtetases Elida Cani, i cili ka
deklaruar si më poshtë:

Ne Tetor te vitit 2018 jam kthyer nga Greqia ne Shqiperi per te bere pregatitjen per dasmen
time me shtetasen Fjoralba Heta.Pasi jam kthyer nga Greqia te gjitha pergatitjet e dasmes i
kisha te rregullta vetm me mungonte kostumi.Kur kam qene tek 21 Dhjetori dhe kam
telefonuar motren time Elida Cani ku i kam thene merre babain dhe nusen dhe zbrisni ne
Tirane se te blejme kostumin tim te dhendrit.Pasi kemi mbaruar babai im ka telefonuar njerin
nga shoferet dhe i gatshem u tregua Arben Gjeci i cili me fugon bene linjen e Zall Bastarit-
Tirane dhe anasjelltas, dhe kur ishte ne rruge te drejte bente manovra duke i dhene mjetit me

dhe shikonte nga pasqyra. Une nuk e dija se mos e kishte me gruan time apo me motren ai po ngacmonte dhe i theme Arbenit qe mbaje mite timonin se na hudhe. Dyshimin e kisha tek motra ime Elida Cani se ke ngacmonte Arbeni. Me date 24.01.2019 rreth 18:00 kam dale nga shtepia dhe i kame thene babait se po iki ne pune si zakonisht dhe berkohe kam zbritur tek lokali i lagjes dhe aty kam pare furgonin e Arben Gjedit, por Arbenin nuk e pashe. Nderkohe pa hyre brenda ne lokal kam telefonuar dhendrin tim Defrim Kurti dhe e kam pyetur se ku ishte. Ai me tha se ishte tek lokali. Une i kam thene hajde tek lokali tjetër tek Fredi. ne kete kohe une kam shkuar tek puna ime dhe i kam kerkuar pergjigjsit tim Maksit, duke nxjerre aresyen i kerkuar leje se kisha babain semure. Ai i ka thene nuk ka leje, dhe mire une po iki. Ne kete kohe kam shkuar ne shtepine time, ne oborr kam marre nje shufer hekuri 50-60 cm, e cila ne fund ishte e shtypur, kete hekur e perdor kam ndenjor tek porta e kashtores. Ne kete moment kam pare tek dera ku depertonte drita, nje hije qe levizi. Ne kete kohe u hap dera dhe doli tek porta e identifikova qe ishte Arben Gjedi, me pa mua dhe filloi te qeshe me ironi. Ne kete moment une ngaqe ai ishte i gjate, kam bere dy hapa mbrapa dhe e kam goditur me hekur mbas koke dy tre here. Mbas e kam goditur Arbenin kam ikur qetesisht ne shtepine time dhe hekurin e kam hedhur midis hapesires se kotecit dhe kashtores. Kur kam shkuar ne shtepi me ka pyetur babai, cfare ke qe je merzitur. Une i kam thene se nuk kame gje dhe kam shkuar te fle. Diten tjetër tek shtepia ka ardhur djali i xhaxhait Aruc Cani dhe me ka thene se kishin gjetur Arben Gjedin te vrare ne rruge, une i kam thene se nuk dija gje. Une nuk kam patur per qellim te vrases Arben Gjedin, por doja ta rrihja qe te vuante ca kohe".

Ne oborrin e baneses se shtetasit Esat Kurti u gjet dhe u fiksua prane nje kasolleje nje shufer metalike me ngjyre ndryshku rreth 65 cm e gjate, ne njeten ane te majes te shtypur mjet qe dyshohet se eshte kryer ngjarja, mjet i cili sekuestrohet ne cilesin e provave materiale

Ne kontrollin e te dyshuarit Defrim Kurti, ne banese ju gjeten 6.2 gram lende e dyshuar si cannabis sativa, me procesverbal peshimi dhe vendim ekzamnimi lende per llojin e permbajtjes dhe perqindjen e THC.

Nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore është kryer arresti i shtetasve Esat, Cani, Elida Cani dhe Dëfrim Kurti, të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 88/2, 301 dhe 301 e 283/1 të Kodit Penal është kryer në oraret 01:40, 23:30 dhe 23:10 të datave 25 dhe 26 Janar 2019..

Për sa i përket arrestimit në flagrance të arrestuarit:

1. Nga ana e policisë gjyqësore janë respektuar kushtet ligjore të parashikuara nga neni 251/1 i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon detyrimin e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore të kryejnë arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet.

2. ka ekzistuar gjendja e flagrancës e parashikuar nga neni 252 i K.Pr.Penale, pasi ai është arrestuar menjëherë pas kryerjes së veprës penale.

3. është përmbushur edhe kushti tjetër ligjor i parashikuar nga neni 258/1 i K.Pr.Penale, pasi kërkesa për vleftësimin e arrestimit është bërë brenda afatit ligjor të dyzet e tetë orëve.

per sa i perket caktimit te mases se sigurimit, ekzistojne 1) kushtet dhe 2) kriteret te parashikuara nga nenet 228 dhe 229 te Kodit te Procedures Penale,

1) Kushtet

Ekziston nje dyshim i arsyeshem e i bazuar ne prova se i arrestuari Esat Cani ka kryer veprën penale të «Plagosjes së rëndë» parashikuar nga neni 88/2 i Kodit Penal. Ky dyshim i arsyeshem bazohet në procesverbalet kqyrjes së vendit të ngjarjes, sekuestrimit të provës materiale, verifikimit të thënieve në vend, procesverbaslit të kqyrjes së kufomës, deklarimeve të shtetasve Beshir Cani etj.

Ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasit Elidfa Cani dhe Dëfrim Kurti, kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal, bazuar në aktet e hetimit paraprak si kqyrje e vendit të ngjarjes, sekuestrimit të provës materiale, deklarime të shtetasve Ibrahim Cani etj.

Ekziston dyshimi i bazuar në prova se shtetasi Dëfrim Kurti ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, bazuar në procesverbalin e kqyrjes së vendit të ngjarjes dhe sekuestrimit të një sasive prej 6.2 gramë lënde narkotike.

- Nuk ka shkaqe padënueshmërie,

- si dhe duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit ekziston rreziku i kryerjes së veprave penale të njëjta.

2) Kriteret për caktimin e masës së sigurimit.

Ne caktimin e llojit te mases se sigurimit personal me karakter shtrengues ndaj te arrestuarit duhet te merren parasysh dhe kriteret ligjore te caktimit te mases te parashikuar nga neni 229 te K.Pr.Penale qe jane :

a) përshtatmëria e masës së sigurimit me nevojën e sigurimit ;

b) ruajtja e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së sigurimit ;

c) si dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale.

Organi i akuzes në caktimin e masës së sigurimit vlerëson rrezikshmërisë shoqerore që paraqesin veprat penale të parashikuara nga nenet 88, 301 e 283 të Kodit Penal.

Vepra penale e parashikuar nga neni 88/2 paraqet rrezikshmëri shoqerore të theksuar pasi është drejtuar ndaj jetës dhe shëndetit të viktimës Gjeci duke i shkaktuar atij vdekje atij. Gjithashtu, veprimet e kryera nga ana e shtetasve Elida Cani dhe Dëfrim Kurti kanë sjellë si pasojë pengimin e zbulimin e së vërtetës duke prishur vendin e ngjarjes, transportuar viktimën larg dhe duke dhënë një version tjetër të ngjarjes tek shtetasit e tjerë.

Gjithashtu, vepra penale e parashikuar nga neni 283 paraqet rrezikshmëri shoqerore pasi përbën krim dhe për të parashikohet një dënim nga 5-15 vjet burgim.

Të gjitha këto rrethana tregojnë se masa që i përmbush nevojat është ajo e « Arrestit në burg », parashikuar nga nenet 238 i Kodit të Procedurës Penale për shtetasit Esat Cani dhe Dëfrim Kurti.

Per keto arsye bazuar ne nenin 228, 229, 258, dhe 244 te Kodit te Procedures Penale,

K E R K O J

1. Të vleftësohet si i ligjshem arresti i shtetasit Esat Cani dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal me karakter shtrengues «Arrest në burg», te parashikuar nga neni 238 të K.Pr. Penal.


7

1. të vlefshësohet si i ligjshëm arresti i shtetasit Dëfrim Kurti dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues «Arrest në burg », te parashikuar nga neni 238 të K.Pr. Penal.

2. të vlefshësohet si i ligjshëm arresti i shtetases Elida Cani dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues «Arrest në shtëpi », te parashikuar nga neni 237 të K.Pr. Penal.

PROKURORE

Alma Bramo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANE

PROCESVERBAL

PËR MARRJEN E TË DHËNAVE NGA PERSONI NDAJ TË CILIT ZHVILLOHEN HETIME

Në Tiranë, me 25.01.2019, ora 23:30, unë Ilir Nerguti, Oficer i Policise Gjyqesore, në Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Tirane, ne bazë të nenit 296 të K. Pr. Penale, mbaj këtë procesverbal për marrjen e të dhënave, në prani të mbrojtësit, nga personi ndaj te cilit zhvillohen hetimet: emri, mbiemri Elida Cani, e bija e Reshid dhe e Hajrije, e datelindjes 27.03.1999, e lindur ne Tirane Bastar i Mesem, Tirane, shtepi private, me gjendje gjyqesore e padenuar me pare, e martuar, me arsim 9 klase, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, 0698294895.

Personit iu spjeguan se:

- Ka të drejtë të mos përgjigjet dhe se edhe po të mos përgjigjet procedimi do të vazhdojë, neni 38/3 i K.Pr.Penale;
- Mund të spjegojë gjithçka që çmon të dobishme për mbrojtjen e tij, neni 39/2 i K. Pr. Penale;
- Cilat janë faktet për të cilat procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje të tij, si dhe të dhënat në ngarkim të tij, neni 256 i K. Pr. Penale;
- Ka të drejtë të zgjedhë një mbrojtës dhe të kërkoj caktimin e një mbrojtësi nga organi procedues, nenet 48, 49, 296e vijues tëi K. Pr. Penale.

Me vullnetin e tij të lire, ai deklarojë:

Pyetje: Ne lidhje me ngjarjen e ndodhur date 24.01.2019 rreth ores 21:30 min ne Bastar i mesem, eshte gjetur i demtuari Arben Gjeçi i cili pasi dergohet ne Spitalin e Traumes Tirane humb jeten nga demtimet ne koke, ju akuzoheni per kryere te Vepres Penale të "Veprimit qe pengojne zbulimin e se vertetes" parashikuar nga neni 301 te K.Penale, a e degjuat akuzen, e kuptoni ate dhe cfare keni per te deklaruar per rrethanat e kryer se kesaj ngjarje ?

Përgjigje: Une ne lidhje me kete ngjarje jape shpjegime ne prezence te avokatit Arben Gramo, dhe ne lidhje me ngjarjen une deklaroi se isha e traumatizuar, nga ngjarja qe ka ndodhur. Une thjeshte me tha burri im Defrim Kurti qe fshije gjakun dhe une e fshiva. Ora ishte afersisht 21:40 min e dates 24.01.2019. Nuk di cfare te theme tjeter per ngjarjen jame e penduar dhe i kame treguar ne deklarimin e meparshem. Une shtetasin Arben Gjeçi e njihja, dhe nuk dua te shprehem me se do te pergjigjem ne Gjykate persa ka ndodhur.

Pyetje: Keni gje tjeter per ti shtuar deklarimit tuaj?

Pergjigje: Jo nuk kame gje tjeter per te shtuar rrethe kesaj ceshtje.
Procesverbali i deklarimit lexohet dhe nënshkruhet pa verejtje.

PERSONI NDAJ TË CILIT ZHVILLOHEN HETIMET

Elida Cani

OFICERI I POLICISË GJYQËS

Illir Nerguti

Prezent av. Mbrojtes

Pamjose Policie

Juljeta Osmani

